

**VENDIM**  
**Nr. 14, datë 13.6.2012**

**PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SARANDË**

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për efekt të mbarimit të afatit operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Sarandë, me:

Drejtues ligjor: z. Qesko Llambro Çakalli

Drejtues teknik: z. Sheme Kamber Lulo

2. Operatori sh.a. UK Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Sarandë, komunat: Aliko, Dhiver, Finiq, Mesopotam.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 13.6.2016.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**